

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6985  
E premte, 1 shtator 2023  
Çmimi 0.40 €

## SBASHK-u: Nagavci dhe Murati synuan shuarjen e sindikatës sonë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

SOT (E PREMTE) NË KOSOVË FILLON VITI I RI SHKOLLOR

# DERI NË 150 EURO PËR ÇANTËN E NJË FILLORISTI



Radhë njerëzish ka pasur në shumë librari të Kosovës të enjten. Në total, prindërit presin të shpenzojnë deri në 150 euro për çantën e filloristit - varësisht edhe çfarë kërkojnë

mësimdhënësit pasi të nisë procesi mësimor. Furnizimi me libra në librari është një praktikë e re në Kosovë, së paku në 15 vjetët e fundit. Ministria e Arsimit i ka shpërndarë falas librat për

nxënësit e shkollave fillore nga viti 2008. Por, sivjet, me vendim të ministres Arbërie Nagavci, tekste shkollore duhet të blihen nga vetë prindërit e nxënësve, me rimbursim

## OSMANI NË TAKIM ME KONGRESISTIN TURNER: MBËSHTETJA E SHBA-së ËSHTË ESENCIALE



## KOMISIONARI I BE-së: JEMI TË GATSHËM TA BËJMË REALITET PËRSHPEJTIMIN E ZGJERIMIT

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



## KRYEMINISTRI RAMA DEKORON FATOS NANON: LUTEM PËR TË, PO LUFTON ME JETËN

## QYTETARËT E PRISHTINËS QË PËSOJNË INFARKT NË KOHË REKORDE DO TË MARRIN TRAJTIM NË KLINIKËN E KARDIOLOGJISË INVAZIVE

## ÇEKU PËR ZJARRIN NË MUZEUN E MUZIKËS NË GJAKOVË: PËRGJEGJËSIT DUHET TA MARRIN DËNIMIN E MERITUAR

### EKONOMI



## MINISTRISË SË BUJQËSISË I DHUROHEN DY DRONË

## AUSTRIA VENDOS KUFIRIN E QIRAVE SI PJESË E LUFTËS KUNDËR INFLACIONIT

### SPORT



## GLIHA ZBULON LISTËN, KORENICA 'HASRETI' I SUPERLIGËS




# Kryeministri Rama dekoron Fatos Nanon: Lutem për të, po lufton me jetën

**TRANË, 31 GUSHT** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e ka dekoruar me Kordonin e Madh me Yll të Mirënjohjes Publike Fatos Nanon, që prej disa ditësh ndodhet në spital.

Nëpërmjet një statusi në rrjetin social "Facebook", Rama vlerëson kontributin e ish-kryeministrit Fatos Nano për vendin dhe shoqërinë "gjatë karrierës së tij me të përpjeta e të tatëpjeta të mundimshme". "Në këto orë të vështira të luftës për jetën, lideri historik i Partisë Socialiste dhe njeriu që vuajtjen e padrejtë të heqjes së lirisë e ktheu në burimin e një fryme liberale në udhëheqje, në një kohë kur Shqipëria përballlej me shëmtinë e egër të një konflikti politik të nxitur nga shpirti i hakmarrjes, padijes, errësirës dhe me egërsinë e pakufishme të një kapërcimi të madh historik, nga izolimi i tejskajshëm komunist drejt demokracisë si sprovë e tejmundimshme, në një tokë të

djegur prej zjarrit e hekurit të perandorive e regjimeve që pasuan njëri-tjetrin qysh prej pavarësimit të Shqipërisë, ku nuk u rrit dot kurrë shtati institucional i shtetit e ku liria e ardhur me furinë e zemëratës popullore solli

bashkë me dritën e së ardhmes edhe plagët e tmerrshme të shkatërrimit të shumëçkaje në emër të luftës për demokraci, meriton sot lutjet tona dhe mirënjohjen tonë për gjithçka të mirë mundi t'i japë vendit dhe



shoqërisë në rolet e rënda që pati gjatë karrierës së tij me të përpjeta e të tatëpjeta të mundimshme", ka shkruar kryeministri Rama. Që të premtën e kaluar ish-kryeministri ndodhet në spital për shkak të një problemi në mushkëri.

Fatos Nano lindi më 16 shtator 1952 në Tiranë. U zgjodh

kryeministër i qeverisë së tranzicionit në vitin 1991, pas rrëzimit të diktaturës komuniste. Socialisti fitoi në zgjedhjet e para demokratike në Shqipëri, më 31 mars 1991. Pas dy muajsh dha dorëheqje, për t'u zgjedhur sërish në vitin 1997 deri në vitin 1998 dhe nga viti 2002 deri në vitin 2005.

## Mbi 70 të vdekur nga zjarri në një ndërtesë në Johannesburg

**JOHANESBURG, 31 GUSHT** - Është rritur në 73 numri i të vdekurve nga zjarri që kaploi një ndërtesë shumëkatëshe të enjten në Johannesburg, qytetin më të madh të Afrikës Jugore, njoftuan autoritetet.

Shërbimi i Emergjent i Johannesburgut tha se më shumë se 50 persona të tjerë u lënduan nga zjarri, i cili shpërtheu në orët e hershme të 31 gushtit. "Aktualisht i kemi 73 të vdekur, kurse janë edhe 52 të lënduar, të cilët janë dërguar në qendra të ndryshme spitalore", tha Robert Mulaudzi, zëdhënës i Shërbimit Emergjent.

Mulaudzi bëri me dije se zjarri tashmë është shuar dhe se operacioni i kërkimit është duke u zhvilluar në ndërtesën e nxirë në qendër të Johannesburgut. Në mesin e viktimave është edhe një fëmijë, theksoi ai. "Po shkojmë nga kati në kat për t'i tërhequr trupat. Kjo është një ditë e trishtueshme për qytetin e Johannesburgut. Unë kurrë nuk kam parë diçka të tillë gjatë 20 vjetëve sa jam në shërbim", theksoi Mulaudzi.

Ende nuk është e qartë se çfarë e ka shkaktuar zjarrin, ndërkohë që njerëzit nga ndërtesa janë



evakuuar plotësisht tashmë.

Mulaudzi theksoi se ndërtesa ishte "një vendbanim joformal" ku

njerëzit e pastrehë ishin vendosur në kërkim të akomodimit pa ndonjë marrëveshje kontrate

formale. Sipas tij, kjo e ka bërë të vështirë kërkimin e njerëzve në këtë objekt.

Në ndërtesë mund të kenë qenë duke jetuar rreth 200 njerëz, sipas dëshmitarëve.

Uzarpimi i jashtëligjshëm i ndërtesave të papërdorura në qendër të qytetit është i madh dhe thuhet se shumë prej tyre janë nën kontrollin e sindikatave kriminale, të cilët marrin qira nga banuesit.

Në qershor zjarri në një ndërtesë të vjetruar në Johannesburg la të vdekur dy fëmijë nën moshën 10-vjeçare, të cilët kishin mbetur të ngjuar në një banesë.

## Franca kërkon vendosjen e çmimit minimal për fluturimet në Evropë

**PARIS, 31 GUSHT** - Ministri francez i Transportit ka bërë thirrje për vendosjen e një çmimi minimal për fluturimet në Evropë, me synim që të luftohen ndryshimet klimatike.

Ministri i Transportit, Clement Beaune, tha në një intervistë për revistën javore "L'Obs" se ai do të dorëzojë këtë propozim të homologët e tij të Bashkimit Evropian në ditët në vijim. "Biletat e avionit prej 10 eurosh nuk mund të ketë kur ne jemi në mes të tranzicionit ekologjik. Kjo nuk është e mundur", tha Beaune.



"Këto çmime nuk reflektojnë çmimin për planetin tonë", shtoi ai.

Linjat ajrore që operojnë me kosto të ulët kanë vërshuar industrinë e fluturimeve në

Evropë, pasi ato ofrojnë tarifa të lira për disa destinacione, me Ryanair që është bërë kompania më e madhe e transportit ajror në rajon.

Por, tarifat e ulëta ndonjëherë nuk mbulojnë as kostot dhe emetimet e gazrave serrë nga avionët e pasagjerëve janë më të mëdha sesa gjatë udhëtimeve me tren. "Unë hapur bëj thirrje për vendosjen e taksave për aktivitetet që shkaktojnë ndotje, në mënyrë që të mund të investojmë në tranzicionin ekologjik", tha Beaune, duke shtuar se qeveria franceze

planifikon t'i rrisë taksat për fluturimet që nisen nga Franca. Po ashtu, sipas tij, ekzekutivi francez do t'i financojë investimet në transportin hekurudhor.

Rritja e taksave për kompanitë që menaxhojnë autostradat në Francë dhe për biletat e linjave ajrore ka të ngjarë që të përfshihen në buxhetin e vitit 2024, që do të bëhet publik në fund të shtatorit. Linjat ajrore me kosto të ulët, po ashtu, kanë qenë burim polemikash në Francë për shkak të praktikave të punës dhe pagave që ua ofrojnë punëtorëve.



# Deri në 150 euro për çantën e një filloristi

Radhë njerëzish ka pasur në shumë librari të Kosovës të enjten. Prindërit presin të shpenzojnë deri në 150 euro për çantën e filloristit - varësisht edhe çfarë kërkojnë mësimeve pasi të nisë procesi mësimor. Furnizimi me libra në librari është një praktikë e re në Kosovë, së paku në 15 vjetët e fundit. Ministria e Arsimit i ka shpërndarë falas librat për nxënësit e shkollave fillore nga viti 2008. Por, sivjet, me vendim të ministres Arbërie Nagavci, tekstet shkollore duhet të blihen nga vetë prindërit e nxënësve, me rimbursim



**PRISHTINË, 31 GUSHT** - Radhë njerëzish ka pasur në shumë librari të Kosovës të enjten. Disa madje kanë zgatur orarin e punës dhe kanë shtuar numrin e punëtorëve për t'i plotësuar kërkesat e konsumatorëve.

Ardiana Thaçi thotë se i ka siguruar gati të gjitha furnizimet për djalë dhe saj që nis klasën e pestë. "Kam blerë shumicën e librave me një çmim prej 63 eurosh. Kanë munguar dy libra të lëndës Njeriu dhe Natyra... Kam blerë edhe fletore, goma, lapsa, çantë e materiale të tjera të nevojshme, që kanë kushtuar rreth 65 euro", tregon Ardiana për Radion Evropa e Lirë.

Në total, ajo pret të shpenzojë deri në 150 euro për çantën e filloristit të saj - varësisht edhe çfarë kërkojnë mësimeve pasi të nisë procesi mësimor. Furnizimi me libra në librari është një praktikë e re në Kosovë, së paku në 15 vjetët e fundit.

Ministria e Arsimit i ka shpërndarë falas librat për nxënësit e shkollave fillore nga viti 2008. Por, sivjet, me vendim të ministres Arbërie Nagavci, tekstet shkollore duhet të blihen nga vetë prindërit e nxënësve,

me rimbursim.

Platforma online e Qeverisë së Kosovës, E-Kosova, ku prindërit kanë mundur të aplikojnë për sigurimin e të hollave, është hapur më 25 gusht - saktësisht një javë para nisjes së vitit të ri shkollor. Ministria e Arsimit ka ndarë nga 80 euro për nxënësit nga klasa e parë deri në të pestën dhe nga 30 euro për ata nga e gjashta deri në të nëntën, pasi të fundit i kanë të siguruar librat nga viti i kaluar.

## Si ka shkuar aplikimi në e-Kosova?

Ardiana thotë se ka aplikuar për rimbursim në e-Kosova më 25 gusht, por deri më 30 gusht - kur REL-i ka biseduar me të - ajo nuk i ka marrë paratë.

Ministria e Arsimit nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it për rrjedhën e këtij procesi, por në një komunikatë për media ka thënë se "mjetet pritet të deponohen në llogari para datës 1 shtator".

Në një tjetër njoftim, kjo ministri ka thënë se nga data 25 deri më 30 gusht më shumë se 92 000 prindër apo kujdestarë

fëmijësh kanë aplikuar për rimbursimin e mjeteve.

Nga qeveria kanë bërë me dije se kanë ndarë rreth 13 milionë euro për subvencionimin e librave dhe materialeve të nevojshme për shkollë.

Në një anketë që ka publikuar Radio Evropa e Lirë në uebfaqen e saj, shumica e pjesëmarrësve e kanë vlerësuar "të duhur" vendimin e Ministrisë së Arsimit për ndarje të subvencioneve për librat.

Por, në Këshillin e Prindërve të Kosovës konfirmojnë për REL-in se shumë prindër kanë shprehur ankesa për pamundësinë e sigurimit të librave pa ndarjen e mjeteve. Shqetësime të ngjashme janë vënë re edhe nga reagimet e disa qytetarëve në rrjetet sociale.

Në grupin "Prindërimi" në Facebook, që ka mbi 51 000 ndjekës, një prej tyre ka shkruar: "... mos e dini se kur dalin paratë për libra të nxënësve? I kam tre fëmijë dhe nuk mund t'i blej".

Në Kosovë paga mesatare është rreth 520 euro, ndërsa ajo minimale sillet nga 130 deri në 170 euro.

Mbi 22 000 familje, ndërkaq, janë me asistencë sociale.

## Libraritë vërshohen nga blerësit

Disa përfaqësues librarish, me të cilët bisedoi REL-i, thanë se kanë mjaftueshëm libra.

Rinor Berisha, menaxher i shitjeve në librarinë "Rilindja" në Ferizaj, tha se për shkak të fluksit të madh të blerësve, ka shtuar numrin e punëtorëve dhe ka zgatur orarin e punës. "Interesimi është jashtëzakonisht i madh. Shumë prindër janë duke blerë libra, edhe pse nuk janë subvencionuar nga ministria", tha ai.

Çmimi i teksteve shkollore për nxënësit e klasave nga e para deri në të pestën sillet nga 40 deri në 70 euro - varësisht nga klasa dhe shtëpia botuese. Blerim Muhaxhiri, nga shtëpia botuese "Dukagjini", tha për Radion Evropa e Lirë se ky botues është i përgatitur për t'i mbuluar të gjitha kërkesat për tekste shkollore.

## Pse Ministria e Arsimit nuk i ka bërë furnizimet sivjet?

Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka thënë se institucioni që drejton ajo ka

dështuar të arrijë marrëveshje me shtëpitë botuese për furnizimin e shkollave me libra, për faktin se, sipas saj, shtëpitë botuese kanë ofertuar çmime shumë më të larta se ato që i vendosin në libraritë e tyre.

Por, një gjë e tillë është mohuar nga përfaqësuesit e disa botuesve. Ata të "Dukagjinit" kanë thënë se oferta që kanë bërë në Ministri ka qenë këtë vit për rreth 4 % më e lirë se vitin e kaluar.

Nga shtëpia botuese "Albas" kanë thënë, po ashtu, se çmimet e teksteve shkollore në librari janë të njëjta me ato që ia kanë ofertuar Ministrisë së Arsimit.

Këto zhvillime kanë nxitur reagimin e disa partive opozitare, të cilat kanë kërkuar dorëheqjen e ministres Nagavci për shkak të, siç është thënë, paaftësive në menaxhimin e sistemit arsimor.

Numri i nxënësve nga klasa e parë deri në të nëntën në Kosovë pritet të jetë rreth 213 000, aq sa ka qenë në vitin shkollor 2022/2023. Në atë vit shkollor procesi mësimor ka nisur me një muaj vonesë për shkak të një greve të mësimeve për paga.





## Osmani në takim me kongresistin Turner: Mbështetja e ShBA-së është esenciale

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të enjten, gjatë një takimi me kongresmenin amerikan Mike Turner, se Kosova ka bërë hapa përmbajtjesorë për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës, ndërsa e ka akuzuar Serbinë për destabilizmin e saj përmes “bandave kriminale”. Osmani ka thënë se mbështetja e ShBA-së në rrugën e Kosovës drejt NATO-s është esenciale

Prishtinë, 31 gusht - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të enjten në takim kongresistin Mike Turner, kryetar i Komitetit të Përhershëm të Dhomës së

Përfaqësuesve të ShBA-së për Shërbimet e Inteligjencës. Raportet me ShBA-në, presidentja Osmani i ka cilësuar strategjike edhe ekzistenciale,

ndaj e ka falënderuar kongresistin Turner për mbështetjen ndër vite, të cilën ai ia ka dhënë Kosovës në rrugën e shtetndërtimit.

Presidentja Osmani ka potencuar se shteti i Kosovës është edhe histori suksesi e ShBA-së. “Përkushtimi i palëkundur i Shteteve të Bashkuara për kauzën e Kosovës ka qenë i domosdoshëm në rrugëtimin tonë drejt pavarësisë dhe shtetësisë”, ka theksuar Osmani.

Në takim me kongresistin Turner, presidentja Osmani ka bërë me dije se synimi i Kosovës është anëtarësimi në

organizatat ndërkombëtare si: NATO, BE, Këshilli i Evropës dhe të tjera.

Në raport me bashkëpunimin me ShBA-në, Osmani ka potencuar atë në sferën e mbrojtjes dhe sigurisë. Kësisoj, presidentja Osmani përmendi aspiratën e Kosovës për anëtarësim fillimisht në Partneritet për Paqe (PfP), e pastaj në NATO, ku mbështetja e ShBA-së është esenciale.

Më tej, Osmani përmendi faktin se Agjencia e Kosovës për Inteligjencë ka bashkëpunim të ngushtë me shërbimet inteligjente të ShBA-së për adresimin e sfidave të përbashkëta të

sigurisë që mund ta cenojnë paqen dhe sigurinë në Kosovë dhe rajon.

Ndërkaq në raport me situatën në veri të vendit, presidentja Osmani ka theksuar se Kosova ka bërë hapa përmbajtjesorë për shtensionimin e situatës dhe se vazhdon të jetë palë konstruktive në këtë proces. Por, ka theksuar obstrukcionet e Serbisë, si dhe veprimet destabilizuese në veriun e Kosovës nëpërmjet bandave kriminale të dirigjuara nga Beogradi. Ajo ripotencoi rëndësinë e zbatimit të plotë të të gjitha detyrimeve që dalin nga Marrëveshja e Brukselit dhe aneksi i Ohrit.

## Komisionari i BE-së: Jemi të gatshëm ta bëjmë realitet përshpejtimin e zgjerimit

PRISHTINË, 31 GUSHT - Komisionari i Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka thënë më 31 gusht, se nëse Këshilli Evropian do, Komisioni Evropian është i gatshëm ta kryejë punën e vet për ta realizuar përshpejtimin e zgjerimit të BE-së. Ai këto komente i bëri teksa u përgjigj në pyetjet rreth propozimit të presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, që viti 2030 të caktohet si afati deri kur edhe Bashkimi Evropian, edhe vendet kandidatë duhet të jenë të gatshme për zgjerim. “Sipas mendimit tim, nëse presidenti i Këshillit dëshiron që më në fund të angazhohet dhe ta bëjë një hap të madh për ta bërë zgjerimin realitet, atëherë ky

është një lajmë i mirëpritur”, ka thënë Varhelyi.

Ai ka thënë se Komisioni Evropian është i gatshëm ta zbatojë çfarëdo propozimi. “Natyrish, Komisioni [Evropian] ka qenë gjithmonë i gatshëm për të bërë çfarëdo propozimi i cili do të na çonte deri te synimi. Nuk mendoj se kjo është çështje e datave, por më shumë çështje e vullnetit dhe rezultateve – rezultateve nga ana jonë dhe nga ana e partnerëve tanë në Ballkanin Perëndimor dhe tri vendet e tjera kandidatë”, ka thënë ai. “Komisioni [Evropian] është i gatshëm të bëjë çfarëdo propozimi dhe këtë do ta shihni që në tetor kur ne do të donim ta paraqesim një propozim domethënës, përfshirë edhe planin e rritjes, që presidentja



tashmë e ka sqaruar në Bratislavë, që do ta shpejtonte jo vetëm integrimin, jo vetëm institucional por edhe real - integrimin real të njerëzve dhe ekonomisë në Bashkimin Evropian”, ka thënë Varhelyi.

I pyetur se cilat vende do të mund të ishin të parat që do të

anëtarësoheshin në BE, ai tha se kjo do të varet nga pyetja se cilat janë më afër dhe cilat do t'i bëjnë më shpejt reformat. “Unë do t'i inkurajoja ato që ta përshpejtojnë punën e tyre. Unë mendoj se të gjitha ato kanë çfarë u duhet dhe ne do të kemi gjithçka në tryezë nga tetori për

të bërë këtë. Le të shpresojmë se jo vetëm një, por të gjithë të jenë të interesuar për këtë ofertë evropiane”, shtoi Varhelyi.

Dy ditë më parë zëdhënësja e Komisionit Evropian, Dana Spinat, tha se KE-ja nuk është e përqendruar në afate kohore në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE), por për t'i ndihmuar vendet kandidatë për të përparuar në këtë proces. Duke iu përgjigjur pyetjeve rreth hapave që duhet të ndërmerren për ta shpejtuar zgjerimin, ai tha se duhet të merren të gjitha vendimet, qofshin ato të vogla apo të mëdha, si vendimet në konferenca ndërqeveritare, vendime për financime dhe vendime për integritime reale, para se vendet të anëtarësohen formalisht në BE.



## SBASHK-u: Nagavci dhe Murati synuan shuarjen e sindikatës sonë

PRISHTINË, 31 GUSHT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka adresuar kritika për Ministrinë e Arsimit dhe qeverinë, ndërsa i ka uruar nxënësit dhe punëtorët e arsimit me rastin e vitit të ri shkollor. “Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut duke ju uruar juve dhe gjithë nxënësve për vitin e ri shkollor ju falënderoj që kësaj radhe nuk kishit kërkesa për veprime sindikale dhe kjo na jepte shpresë se ky vit shkollor do të ketë fillim dhe rrjedhë të mbarë, por MASHTI u kujdes që kjo të mos ndodh duke sjell vendim të gabuar për tekstet shkollore, vendim ky që ka krijuar shqetësime e stres të punëtorët arsimorë në mësimin shqip, por dhe të kolegët tanë në mësimin në gjuhën boshnjake e turke”, theksohet në njoftimin e SBASHK-ut.

Ky institucion ka kërkuar angazhim maksimal të mësimdhënësve që pajisja me tekste shkollore të bëhet në mënyrën më të mirë të mundur, e sidomos për nxënësit që vijnë nga familje me gjendje më të rënduar ekonomike.

Ndërsa specifikisht duke përmendur ministren Arbërie Nagavci, nga kjo sindikatë kanë

vlerësuar se ajo bashkë me ministrin Hekuran Murati kishin synim shuarjen e SBASHK-ut. “Anëtare e anëtarë të SBASHK-ut, ministrja Nagavci në vend që të kërkojë falje nga prindërit, nxënësit e mësimdhënësit për problemin që ka krijuar lidhur me tekstet shkollore, ajo kishte bërë pyetje se kë përfaqëson Jasharaj. Ajo, si duket, ka besuar se do të jep rezultate plani i saj dhe i ministrit Murati se duke krijuar pengesa, që nuk ndodhin në asnjë vend demokratik të botës, punëtorët e arsimit nuk do të regjistrohen si sindikalistë në e-Kosova dhe kështu do të shuhet SBASHK-u. Por, Nagavci nuk ia paskan treguar lajmin se SBASHK-u nuk u shua, por vazhdon rrugëtimin me unitet të plotë e me shumë angazhime në shërbim të arsimit dhe do ta ngrit zërin në emër të anëtarësisë”, është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.

SBASHK-u u është kundërpërgjigjur edhe deklaratave të Nagavcit rreth dilemave të përfaqësimit të Rrahman Jasharajt. “Pra, Jasharaj përfaqëson mijëra e mijëra anëtare e anëtarë të SBASHK-ut që nga çerdhet e deri në universitete. Zonja



Nagavci me tendencën për të krijuar përçarje deklarohet se ky vendimi i ri për tekstet shkollore qenka edhe në shërbim të mësimdhënësve. Ajo, mbase ka menduar se kështu i kursen nga lodhja e ndarjes se teksteve shkollore për nxënësit e tyre, por ata nuk e duan këtë kujdes sepse me kënaqësi e të lumtur e kanë kryer këtë veprim duke i parë të gëzuar nxënësit për tekstet e reja shkollore”, është thënë në

njoftimin e SBASHK-ut. Madje në fund, SBASHK-u ka specifikuar rastet kur qeveria ndëshkonte me ndalesë pagash punëtorët e arsimit që kishin grevuar. “Sa është kujdesur e kujdeset Nagavci për punëtorët e arsimit u pa kur i gëzohej angazhimit të qeverisë për ndëshkim me ndalim pagash pse punëtorët e arsimit kishin qëndruar arsyeshëm në grevë. Dhe kur u bënte presion edhe

me inspektorë që të mbajnë mësim për të kompensuar orët e humbura në grevë. Ministre mos u mundoni kot se sindikatën tonë u munduat ta shuani, por SBASHK-u ishte dhe mbetet sindikatë e punëtorëve të arsimit që nga çerdhet e deri në universitete dhe do të vazhdojë të jetë zë i tyre sepse ata janë bashkë në SBASHK”, është thënë në njoftimin e SBASHK-ut.

## Vuçiçi për takimin me Lajçakun: Ka shumë ide, por Prishtina s’do zgjidhje

Prishtinë, 31 gusht - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, tha se “ka shumë ide, vetëm zgjidhjet po mbarojnë”, kur u pyet se a ka ndonjë ide të re për situatën në Kosovë, në takimin me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, transmeton agjencia serbe e lajmeve “Beta”.

Presidenti serb u takua me Lajçakun një ditë më parë, më 30 gusht. “Mund të ishim ulur dhjetë orë. Kam frikë se do të ishte e vështirë të gesh një zgjidhje kur flet me njerëz që nuk kërkojnë zgjidhje, kur flet me njerëz nga Prishtina që kërkojnë arsye për konflikte dhe sulme ndaj popullatës serbe në veri të Kosovës”, tha ai.

Vuçiçi theksoi se këto gjëra “nuk i thotë rastësisht”, sepse tha se dëshira e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, është t’i “dëbojë” serbët nga atje.

“...Mos ta përmendi sa mijëra kilometra jemi larg nga formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Prishtinës nuk i shkon mendja që kjo të ndodhë”, tha Vuçiçi.

Lajçaku ka njoftuar në profilin e tij në rrjetin social X, të njohur më parë si Twitter, se më 30



gusht kishte diskutuar me Vuçiçin për “takimin e radhës të nivelit të lartë në shtator, përpjekjet për uljen e tensioneve dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja lokale në veri të Kosovës, si dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të nënshkruara gjatë dialogut”.

Ky takim u zhvillua pasi Lajçaku më 28 gusht njoftoi se kishte një “takim të rëndësishëm” me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, në marginat e Forumit Strategjik të Bledit, në kuadër të

përgatitjeve për takimin e radhës të nivelit të lartë, i cili planifikohet të mbahet në shtator.

Më 30 gusht Bashkimi Evropian përsëriti thirrjen e tij drejtuar Kosovës dhe Serbisë për t’i krijuar kushtet për vazhdimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Më 3 qershor BE-ja njoftoi se pret që Kosova dhe Serbia të sillen me përgjegjësi dhe të angazhohen menjëherë në

dialog për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për situatën në veri të Kosovës, një zgjidhje që garanton siguri dhe demokraci pjesëmarrëse për të gjithë qytetarët dhe që hap rrugën për zbatimin e marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve të arritur më 27 shkurt.

BE-ja më pas deklaroi se kjo zgjidhje përfshin fillimin e punës për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë serbe pa vonesa apo

parakushte të mëtejshme, si dhe se autoritetet e Kosovës duhet t’i shpallin zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komunat në veri të vendit sa më shpejt që të jetë e mundur.

Vuçiçi dhe Kurti u takuan për herë të fundit në Bruksel më 2 maj, nëntë ditë pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme lokale në veri të Kosovës, të cilat u bojkotuan nga serbët lokalë. Gjatë atij raundi të dialogut të Brukselit u miratua Deklarata për Personat e Zhdukur dhe u paraqit drafti i parë i Statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Të dy kishin qenë në Bruksel edhe më 22 qershor, në mes të një krize në veri të Kosovës, por atëherë nuk kishin zhvilluar takim të përbashkët.

Përshkallëzimi i fundit në veri të Kosovës filloi më 26 maj, kur kryetarët e rinj të komunave me shumicë serbe, shqiptarë etnikë të zgjedhur në zgjedhjet e bojkotuar nga serbët, hynë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, me ndihmën e Policisë së Kosovës. Që atëherë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër komuna në veri të Kosovës.



# Në 15-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës u promovua libri "Politika e jashtme dhe marrëdhëniet bilaterale të Kosovës" i autorit dr. Liridon Lika

Më 14 prill të këtij viti (2023), në 15-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, dr. Liridon Lika (editor/autor), botoi librin me titull "Politika e jashtme dhe marrëdhëniet dypalëshe të Kosovës". Libri u botua në gjuhën angleze nga shtëpia botuese e njohur "Routledge" në Mbretërinë e Bashkuar.

Ky libër i përbashkët analizon politikën e jashtme dhe marrëdhëniet bilaterale të Republikës së Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shqipërinë, Austrinë, Belgjikën, Kroacinë, Francën, Gjermaninë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Suedinë, Turqinë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Këto shtete zënë zyrtarisht një vend të rëndësishëm në politikën e jashtme të Kosovës me të cilat Kosova ka lidhur marrëdhënie diplomatike, duke përfshirë hapjen e ambasadave në kryeqytetet e tyre dhe anasjelltas. Për më tepër, këto vende janë anëtare (ose kërkojnë t'i bashkohen) strukturave perëndimore, sikurse NATO dhe/ose Bashkimi Evropian (BE) - dy organizata të rëndësishme ndërkombëtare në të cilat Kosova dëshiron të anëtarësohet.

Kështu që, çdo kapitull i librit u kushtohet marrëdhënieve dypalëshe të Kosovës me një shtet të lartpërmendur me të cilin Kosova ka vendosur marrëdhënie diplomatike.

Qëllimi i këtij libri është të paraqesë kontribute të ndryshme nga akademikë, diplomatë dhe studiues të interesuar për Republikën e Kosovës, marrëdhëniet e saj me shtetet e tjera dhe politikën e saj të jashtme. Ideja e librit lidhet drejtpërdrejt me nevojën për ta dokumentuar më mirë politikën e jashtme dhe marrëdhëniet dypalëshe të Kosovës.

Për ta analizuar politikën e jashtme dhe marrëdhëniet bilaterale të Republikës së Kosovës, projekti i librit ka mundur të llogarisë në kontributin e disa studiuesve dhe diplomatëve të njohur. Të gjithë kontribuuesit e kapitujve të këtij libri janë shqiptarë nga trojet etnike shqiptare.

Ky libër ka për qëllim të kontribuojë në pasurimin e literaturës ekzistuese shkencore mbi këtë temë, si dhe të sjellë diçka të re në një nga aspektet e rëndësishme strukturore të

politikës së jashtme të një shteti të ri siç është Republika e Kosovës. Rëndësia e këtij libri është domethënëse. Deri më tani librat për Kosovën janë përqendruar kryesisht në rolin e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në krijimin e shtetit të Kosovës, njohjen, demokratizimin dhe europianizimin. Megjithatë, shumë pak studime kanë analizuar politikën e jashtme të Kosovës dhe marrëdhëniet e saj bilaterale me shtetet e lartpërmendura.

Literatura ekzistuese për politikën e jashtme dhe marrëdhëniet dypalëshe të Kosovës nuk është as e gjerë dhe as e përditësuar. Pra, ka ekzistuar nevoja për të zhvilluar njohuri për këtë aspekt të rëndësishëm të shtetndërtimit të Kosovës.

Përfundimi i këtij studimi është rezultat i një pune kolektive intensive dhe të rregullt, gati dyvjeçare.

Përveç Liridon Likës, disa nga kapitujt e këtij libri janë shkruar edhe nga autorët: Afrim Krasniqi, Anton Vukpalaj, Ardian Shahini, Armend Bekaj, Bernard Nikaj, Daut Dauti, Drilon S. Gashi, Engjellushe Morina, Enika Abazi, Faruk Ajeti, Pëllumb Kelmendi, dhe Shkëndije Geci Sherifi.


Për më tepër, botimin e këtij libri e mbështetën edhe profesorët Arben Hajrullahu, Bekim Baliqi, Bashkim Iseni, Vjosa Musliu, Aidan Hehir, Pol Barges, Sebastian Santander, Sophie Vanhoonacker dhe Thomas Conzelmann.

Që nga pavarësia e saj në vitin 2008, Republika e Kosovës ka miratuar një politikë të jashtme në përputhje me vlerat dhe interesat e saj strategjike; një politikë të jashtme që synon ta forcojë sigurinë e Kosovës dhe ta promovojë lulëzimin e saj socio-ekonomik në bashkëpunim me vendet kryesisht perëndimore.

Politika e jashtme e Kosovës synon të zhvillojë dhe përmirësojë pozitën e shtetit në skenën ndërkombëtare si dhe ta ushtrojë sovranitetin shtetëror.

Libri tregon se Kosova ka konsoliduar shtetndërtimin dhe sovranitetin e jashtëm përmes thellimit të marrëdhënieve dypalëshe me aleatët dhe partnerët e saj.

Libri i përgjigjet pyetjes kërkimore: cilët faktorë kanë formësuar politikën e jashtme dhe marrëdhëniet e Kosovës me



shtetet e lartpërmendura?

Republika e Kosovës është një shtet evropian, me një popullsi prej rreth 2 milionë banorësh, shumica prej të cilëve janë nën moshën 30 vjeçare.

Pas pavarësisë, së bashku me përkushtimin e saj për konsolidimin e sovranitetit të brendshëm, Kosova kishte prioritet konsolidimin e sovranitetit të jashtëm përmes politikës së saj të jashtme. Kështu që, Kosova filloi të krijojë infrastrukturën ligjore dhe institucionale për të zbatuar politikën e saj të jashtme.

Rezultati i politikës së jashtme të Kosovës për periudhën 2008-2023 mund të përmbledhet në këto 4 pika: Së pari, përmes aleancave të saj me shtetet perëndimore, kryesisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, politika e jashtme e Kosovës ka arritur të rris numrin e njohjeve zyrtare, dhe të bëhet anëtare e organizatave ndërkombëtare, si dhe të ushtrojë sovranitetin e saj në skenën ndërkombëtare.

Njohjet e Republikës së Kosovës kanë krijuar efekte politike dhe juridike. Kosova është njohur zyrtarisht nga shumica e shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Me 117 njohje nga e mbarë bota, Kosova ka forcuar pozitën e saj si shtet sovran në skenën ndërkombëtare. Përveç kësaj, rreth 170 vende në mbarë botën tashmë njohin pasaportat dhe dokumentet e identitetit të lëshuara nga autoritetet kosovare. Kosova gjithashtu është bërë

anëtare e plotë e shumë organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare politike, ekonomike, kulturore dhe sportive.

Së dyti, shtetet më të pasura në botë, veçanërisht shumica e vendeve perëndimore dhe aleatët e tyre, e kanë njohur tashmë Kosovën dhe vazhdojnë të mbështesin përpjekjet e shtetit tonë për t'u anëtarësuar më tej në organizatat ndërkombëtare.

Së treti, të gjitha vendet fqinjë përveç Serbisë, përkatësisht Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, e kanë njohur zyrtarisht pavarësinë e Kosovës dhe po bashkëpunojnë aktivisht me Kosovën. Këto vende kanë hapur ambasadat e tyre në Prishtinë dhe anasjelltas.

Së katërti, shumica e vendeve evropiane tashmë e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Kjo është e rëndësishme edhe për faktin se Kosova është në Europë dhe synon të integrohet në BE.

Republika e Kosovës po përballet me kërcënime, pengesa dhe sfida nga Serbia dhe Rusia. Prandaj, përmes politikës së jashtme dhe marrëdhënieve dypalëshe me vendet perëndimore, Kosova kërkon mbi të gjitha të garantojë sigurinë, integritetin territorial dhe sovranitetin e saj. Pra, Kosova ka zhvilluar një aleancë me fuqitë perëndimore, kryesisht me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat i sigurojnë mbështetje dhe mbrojtje.

Për më tepër, për të konsoliduar më tej sovranitetin e jashtëm, si dhe të mbrojnë interesin e saj shtetëror, Kosova themeloi dhjetëra misione diplomatike jashtë vendit.

Ndërmjet viteve 2008 dhe 2023, Kosova ka akredituar përafërsisht 65 misione diplomatike dhe konsullore në vende të ndryshme në të gjitha kontinentet.

Misionet diplomatike të Kosovës në vendet e analizuara në këtë libër kontribuan në forcimin e marrëdhënieve bilaterale me vendin pritës, nënshkruan marrëveshje të shumta bashkëpunimi dypalësh, ofruan dhe vazhdojnë të ofrojnë shërbime konsullore dhe të përfaqësojnë interesat e Kosovës

jashtë vendit.

Kapitujt e këtij libri tregojnë se që nga viti 2008 e deri më tani, Republika e Kosovës ka zhvilluar marrëdhënie të mira bilaterale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe disa vende evropiane, duke mbuluar fusha të ndryshme si diplomacia, politika, ekonomia, aspektet ushtarake dhe kulturore. Në këtë drejtim edhe mërgata shqiptare ka luajtur një rol të madh.

Prioritetet e politikës së jashtme të Kosovës mbeten: rritja e numrit të njohjeve dhe anëtarësimi i plotë në organizata të ndryshme ndërkombëtare duke përfshirë Interpolin, Këshillin e Evropës dhe OKB-në.

Kosova po synon gjithashtu të bëjë përparim në integrimet euroatlantike, veçanërisht në rrugën drejt anëtarësimi në NATO dhe BE.

Si përfundim, në këtë libër theksohet se politika e jashtme e Kosovës është pro-perëndimore dhe e orientuar drejt anëtarësimi në strukturat euroatlantike.

Përafrimi i Kosovës me fuqitë perëndimore i ka rrënjët në marrëdhëniet e saj të kaluara, mbështetjen e tanishme dhe aspiratat e së ardhmes.

Kosova ka lidhje të rëndësishme me Perëndimin dhe ndan vlera të përbashkëta e parime universale me aktorët perëndimorë.

Dhe kështu për fund, ky libër është me interes kyç për studiues, diplomatë dhe studentë të shkencës politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Liridon Lika (ed.) (2023), Kosovo's Foreign Policy and Bilateral Relations, London and New York: Routledge.

<https://www.routledge.com/Kosovo-Foreign-Policy-and-Bilateral-Relations/Lika/p/book/9781032443171>

Të dhëna rreth autorit/editorit të librit:

Dr. Liridon Lika është ligjërues në Qendrën për Studime të Marrëdhënieve Ndërkombëtare (Center for International Relations Studies - CEFIR) të Departamentit të Shkencave Politike të Universitetit të Liezhës (Université de Liège) në Belgjikë.





## Në përmbyllje të "Muajit të Rinisë", Krasniqi: Krenar me të rinjtë tanë

PRISHTINË, 31 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka shkruar për përmbylljen e "Muajit të Rinisë" të organizuar nga Rinia Demokratike e Kosovës. Ai ka

thënë se gjatë këtij muaji ka pasur energji pozitive dhe bashkëbisedime përmbajtësore me të rinjtë e mrekullueshëm të Kosovës. "Me aktivitete nga më të ndryshmet prej diskutimeve, ngjarjeve

kulturore, kujdesit për mjedisin, sfidimit në sporte të ndryshme, e deri te aksionet simbolike si reagim ndaj keqqeverisjes së vendit, për një muaj rresht, djem e vajza të reja anembanë

Kosovës shkëmbyen përvojat dhe idetë e tyre për të ardhmen që e ëndërrojnë këtu. Mbrëmje fantastike. Krenar me të rinjtë tanë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



## Qytetarët e Prishtinës që pësojnë infarkt në kohë rekorde do të marrin trajtim në Klinikën e Kardiologjisë Invazive

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 GUSHT - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe komuna e Prishtinës, pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, kanë filluar zbatimin e pilotprojektit përmes të cilit pacientët e rajonit të Prishtinës që pësojnë infarkt akut të miokardit do të kenë mundësi që në kohë rekorde të marrin trajtim në kuadër të Klinikës së Kardiologjisë Invazive, përkatësisht të sillen për koronarografi dhe stentim pa humbur kohë.

Me këtë rast, drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, tha se ShSKUK-ja përmes Klinikës së Kardiologjisë do të mundësojë që pacientët që pësojnë infarkt të miokardit do të sillen në Kardiologji Invazive nga

Enti i Urgjencës së komunës së Prishtinës, duke shfrytëzuar kohën që në mjekësi njihet si koha e "artë" në reagim të shpejtë. Sipas tij, ky është vetëm fillimi i projektit që parashihet të zgjerohet në tërë Kosovën.

Këtë bashkëpunim e kanë vlerësuar edhe nënkryetari i komunës së Prishtinës, Alban Zogaj dhe drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i komunës së Prishtinës, Izet Sadiku, të cilët kanë falënderuar ShSKUK-në, duke ofruar të gjitha kapacitetet mjekësore dhe infrastrukturore për ta zbatuar këtë projekt për pacientët.

Për rolin dhe rëndësinë e projektit foli edhe Artan Ahmeti, kardiolog i Klinikës së Kardiologjisë, i cili ceku përfitimet shëndetësore që do të kenë pacientët përmes realizimit të këtij projekti.



## Shefi i grupit parlamentar i AAK-së i numëron 10 dështimet e qeverisë Kurti



Prishtinë, 31 gusht - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka shkruar në "Facebook" se qeveria Kurti që dy vjet e gjysmë ua ka rënduar jetën qytetarëve të vendit. Ai ka theksuar se edhe Amerika, shteti me ekonominë më të fortë në botë, po shikon lehtësimin e jetesës së familjeve amerikane në raport me shpenzimet bazike, si barnat, sigurimet e shumë të tjera. "Qeveria jonë që dy vjet e gjysmë qytetarëve vetëm sa ua rëndon jetesën. Disa argumente, po ia nisim prej fundit: 1. Librat shkollorë; 2. Pagat në sektorin publik; 3. Lista esenciale e barnave; 4. Pensionistët; 5. Policët; 6. Mjekët; 7. Infermierët; 8. Veriu i Kosovës - pika më e ndjeshme e

Kosovës. 9. Sanksionet; 10. Sulmi ndaj mediejeve. Madje kjo qeveri jo që po ua lehtëson jetesën qytetarëve, por i mashtroi të gjithë ata që priten zhvillim ekonomik e luftim të korrupsionit", ka shkruar Tahiri. Ai ka thënë se më e keqja, ua humbi shpresat për një të ardhme më të mirë gjeneratave të ardhme në Kosovë. "Kjo pasiguri e madhe për të ardhmen lidhet me ekonominë e rënduar të vendit, punësimin dhe kushtet e jetës. Ky drejtim politik i kësaj qeverisje po e dërgon vendin në humnerë para shkatërrimit të përgjithshëm. Po krijojnë skandale në të gjitha sferat për ta mbuluar dështimin e mashttrimin", ka shkruar Besnik Tahiri.

## Çeku për zjarrin në Muzeun e Muzikës në Gjakovë: Përgjegjësit duhet ta marrin dënimin e merituar

PRISHTINË, 31 GUSHT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka reaguar pasi ndërtesa e Muzeut të Muzikës në Gjakovë është përfshirë nga

zjarri të mërkurën. Ai ka thënë se është thellësisht i prekur nga ky krim ndaj trashëgimisë kulturore të Gjakovës. "Të gjithë përgjegjësit duhet të

marrin dënimin e merituar. Ndërtesa e Muzeut të Muzikës, aseti Taphanja në Gjakovë do të restaurohet dhe do të kthehet në gjendjen origjinale.

Pas restaurimit, si ministri do t'i marrim të gjitha masat për funksionalizimin e muzeut", ka reaguar Çeku në "Facebook".





## Rritet numri i turistëve në Kosovë

PRISHTINË, 31 GUSHT - Në korrik të këtij viti numri i vizitorëve vendorë dhe të huaj ishte 71 mijë e 341, prej tyre 34,73 për qind, ishin vendorë dhe 65,27 për qind ishin të jashtëm. Krahasuar me muajin korrik të vitit 2022 sa ishin 53 mijë e 820 vizitorë, kishte rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve për 32,6 për qind. Agjencia e Statistikave

njofton se numri i netqëndrimeve ishte 177 mijë e 383, prej tyre 42,64 për qind nga vendorët dhe 57,36 për qind nga të huajt.

Numri i vizitorëve të brendshëm dhe netqëndrimet e tyre sipas rajoneve:

Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm e ka rajoni i Pejës me 7 582 vizitorë dhe 38 145 netqëndrime. "Sa

iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (korrik 2022), ka rritje të vizitorëve për 21,24 %. Në total, 45 566 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh është nga: Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Turqia etj", thuhet në raportin për Statistikat e Hotelarisë për muajin korrik 2023 të publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK).



## Ministresë së Bujqësisë i dhurohen dy dronë

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 GUSHT - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konkretisht Agjencia Pyjore e Kosovës, në një ceremoni zyrtare ka pranuar dy dronë - donacion nga programi "Mbështetje për fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve në Kosovë", i financuar nga Ambasada Suedeze në Prishtinë dhe nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe i zbatuar nga Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara - FAO.



Faton Peci, ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në ceremoninë e pranidorëzimit të këtyre dronëve, u shpreh se kjo ndihmë është shumë domethënëse për sektorin dhe për arritjen e objektivave të përbashkëta që i

kemi me partnerët tanë. "Përmes përdorimit të teknologjisë moderne në mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve, siç janë edhe këta dronë me mundësi dhe performanca të jashtëzakonshme, do të kemi mundësi më të mira për monitorimin e shfrytëzimit të pyjeve me fokus të posaçëm në evidentimin dhe parandalimin e prerjeve të paligjshme të pyjeve dhe ruajtjen e tyre si pasuri kombëtare", tha ministri Peci.

Ndërsa Naser Krasniqi, përfaqësues vendor nga FAO, në prani të ministrit Peci, bëri demonstrimin e funksionimit të dronëve të cilët kanë

performancë të jashtëzakonshme, si dhe ofrojnë kapacitete të larta të monitorimit dhe incizime për analiza të ndryshme të terreneve pyjore.

Para dorëzimit të këtyre pajisjeve programi i FAO-s organizoi trajnim katërditor për personelin e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës të cilët do të jenë përgjegjës për përdorimin e këtyre dronëve. Trajnimi kishte për qëllim njoftimin për procedurat dhe aspektet ligjore që kërkohen në përdorimin të tyre në Kosovë si dhe tema teknike rreth mundësive dhe mënyrës së përdorimit të tyre në pylltari.

## Austria vendos kufirin e qirave si pjesë e luftës kundër inflacionit

VJEN, 31 GUSHT - Kancelari Karl Nehammer dëshiron ta "mbajë jetën të përbalueshme". Për këtë Qeveria e Austrisë zbaton masa për ta luftuar rritjen e çmimeve. Ndër të tjera, çmimet e një pjese të madhe të qirave do të kufizohen. Qeveria konservatore dhe e gjelbër e Austrisë po vendos kufizime të çmimeve për një pjesë të madhe të qirave si pjesë e luftës kundër inflacionit. "Gjatë tre viteve të ardhshme qiratë do të rriten vetëm një herë në vit me një maksimum prej 5-përqindësh", tha kancelari Nehammer në Vjenë.

Sipas zëvendëskancelarit Werner Kogler, do të përfitojnë nga kjo 75 për qind e të gjitha qirave. Një zgjidhje përtej kësaj periudhe po hartohet

aktualisht. Nga të dhënat e qeverisë disa sektorë të tregut të pasurive të paluajtshme në vitin 2024 i priste një rritje prej 15-përqindësh e qirasë. Nehammer tha se kjo është ajo që duam të shmangim përpara një seance të posaçme të parlamentit austriak për rritjen e çmimeve të kërkuar nga opozita.

### Kontroll për fitimet e mëdha

Kjo masë është pjesë e një pakete më të gjerë për ta luftuar inflacionin. Fundjavën e kaluar qeveria njoftoi se donte të vendoste më shumë mbi të ashtuquajturat fitime të rastësishme nga kompanitë që



nxjerrin fitime nga lëndët djegëse fosile. Deri tani kjo bëhej vetëm nëse fitimi ishte 20 për qind më i lartë se mesatarja e fitimit të viteve të kaluara. Në të ardhmen kjo

vlerë do të vendoset në 10 për qind. Që para verës, ÖVP dhe të Gjelbrit kishin rënë dakord t'i detyronin grupet e energjisë elektrike të paguanin më shumë.

### "Ta mbajmë jetën të përbalueshme"

Përveç kësaj, çmimet e taksës së autostradës dhe biletës për klimën, të cilat duhet ta bëjnë udhëtimin me tren më tërheqës, nuk duhet të rriten. "Ne do të vazhdojmë të sigurojmë që njerëzit të marrin lehtësim të drejtpërdrejtë dhe që jeta të mbetet e përbalueshme", ka përfunduar Nehammer.

Në total, vëllimi i lehtësimit për qytetarët do të arrijë në 40 miliardë euro midis viteve 2024 dhe 2026 falë ndihmës së drejtpërdrejtë dhe uljes së taksave, siç është eliminimi i progresionit të ftohtë. /DW

## Gjermania miraton uljen e taksave për bizneset në 15 për qind

BERLIN, 31 GUSHT - Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, ministri i Ekonomisë, Robert Habeck dhe ai i Financave, Christian Lindner, kanë paraqitur rezultatet e lehtësimit tatimor për bizneset, më pak burokraci, më shumë digjitalizim.

Qeveria e Scholzit është pajtuar për një paketë lehtësimi tatimore me vlerë rreth 7 miliardë

euro në vit për bizneset me qëllim të rigjallërimit të ekonomisë më të madhe të Evropës.

Plani përfshin një shpërblim për investimet në kursimin e energjisë. Elementi qendror është një shpërblim për investimet në mbrojtjen e klimës: një prim tatimor investimi prej 15-përqindësh të shumës së investimit do të paguhet pavarësisht

fitimit.

Ka edhe ndryshime të rregullave për ta bërë më të lehtë për kompanitë që t'i amortizojnë humbjet e tyre. Në veçanti, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të përfitojnë nga një zgjatje e kompensimit të humbjeve. Mundësitë e reja të amortizimit do ta përmirësojnë likuiditetin e kompanive dhe t'i inkurajojnë ato të investojnë.





# Profesor Çabej dhe kritikët e tij liliputë



Në dhjetëditëshin e parë të këtij muaji, kampi i patriotëve folklorikë shpërtheu si lavë vullkani, duke derdhur pa hesap sharje, fyerje e anateme mbi prof. Eqrem Çabejn, një prej figurave më përfaqësuese të gjuhësisë shqiptare. Shkak për këtë u bë një video me fjalën e tij, e hedhur në internet me rastin e 115-vjetorit të lindjes. Njerëz që s'kanë haber nga shkenca e gjuhësisë dhe urithë pa emër të rrjeteve sociale, që s'dinë të shkruajnë shqip, hodhën baltë mbi veprën dhe kontributet e mëdha të prof. Çabejt në fushën e leksikologjisë historike të shqipes, duke e akuzuar se 93% (për disa të tjerë 97%) të fjalëve të shqipes i nxjerr me prejardhje të huaj. Kjo akuzë nuk është e re. Ajo është shqiptuar së pari nga Agron Dalipaj, i diplomuar për ekonomi agrare, të cilin televizionet tona ua paraqesin shikuesve si “gjuhëtar”, si “profesor”. Në artikullin e tij “Eqrem Çabej, shenjtori apo

djalli i gjuhës shqipe”, të botuar aty nga mesi i vitit 2012, ky ngre akuza ndaj prof. Çabejt dhe gjuhësisë shqiptare, që nuk kanë thënë se “gjuha jonë ka pjellë greqishten e latinishten” dhe kanë bërë të kundërtën e asaj që thonin rilindësit se “gjuha jonë është më e vjetra nga gjithë gjuhët europiane”. Për Dalipajn, “Studime etimologjike në fushë të shqipes” është “vepra më joshkencore” dhe “më djallëzore”, “qëllimi final” i autorit të së cilës “ka qenë që t'u imponojë shqipfolësve se gjuha që flasin ata, në masën më të madhe të leksikut, nuk është e tyre por e serbëve, bullgarëve, grekërve, latinëve etj., etj. dhe këtë e ka mbështetur në pseudoshkencë”. Çabej, thotë Dalipaj në artikullin e tij, “është Djalli i gjuhës shqipe, që na e shfaqin si engjëll”, “kryedhunuesi i shqipes”, “zjarrvënësi i gjuhës shqipe” etj.

Ky vlerësim paraqet në formën

më agresive thelbin e anatemeve që i bëhen prof. Çabejt dhe veprës së tij nga etimologët popullorë, numri dhe egërsia e të cilëve është shtuar ndjeshëm. Jo më pak agresive ndaj Akademisë sonë të Shkencave dhe ndaj profesorëve Çabej e Demiraj, që janë dy studiuesit kryesorë në fushën e historisë së gjuhës shqipe, është edhe Shoqata e pellazgologëve. Nga këta “etimologë” janë botuar llojlloj librash, në të cilat fjalë të gjuhëve të huaja, përfshirë edhe gjuhë të largëta si japonishtja e kinëzishja, shpjegohen si fjalë të ardhura nga shqipja; fjalorë “etimologjikë” që zbërthejnë fjalët e shqipes ose që greqishten e vjetër e shpjegojnë me gegërishten. Sepse, një nga tezat themelore të tyre është se gegërishtja është dialekti më i vjetër i shqipes, nga i cili ka rrjedhur greqishtja e Homerit! Për ironi, ndonjë nga këta libra është paraqitur edhe në sallën e

konferencave të Akademisë sonë të Shkencave!

Gjuha si mjet themelor komunikimi ka qenë që në krye të herës edhe objekt soditjeje. Gjetja e etimologjive të fjalëve është një punë tërheqëse edhe për njerëz që nuk janë specialistë të gjuhës, që shtyhen nga kërsëria për të ditur se nga rrjedh kjo apo ajo fjalë. Duke hamendësuar rreth prejardhjes së fjalëve, folësit e thjeshtë interpretojnë fjalë të gjuhës së tyre, po sidomos fjalë të huaja, duke u nisur nga ngjashmëria fonetike e tyre apo e pjesëve të tyre me fjalë të gjuhës së vet. Dhe jo rrallë ndodh që fjala e përfutur në këtë mënyrë të bëhet pjesë e fjalorit të gjuhës. Si shembuj mund të sjellim fjalën krahathatë nga krahathadër “zog grabitqar si skifteri”, e përfutur nëpërmjet interpretimit të pjesës së dytë thadër si “thatë”. Të vjetrit dallëndyshes i thoshin edhe dredhan(d)yshe, duke e interpretuar pjesën pa kuptim

dalla si “dredhë”, ngaqë dallëndyshja, kur fluturon, bën dredha. Në raste të tjera, një fjalë e gjuhës përfutet nga shqiptimi i gabuar i një fjale të huaj. P.sh., fjala gringo “amerikan”, që fillimisht ka pasur kuptimin “i huaj”, është përfutur nga shqiptimi i shtrembëruar i fjalës spanjolle griego “grek”. Në shqipe, fjala turke tërbzan është bërë trapazan, ku rrokja tërb me etimologji popullore është zëvendësuar nga fjala shqipe trap. Fjala rifuxho “ngarkesë rifuxho” është përfutur me etimologji popullore nga fjala italiane rinfusa (carico alla rinfusa), duke e shqiptuar “rifuxho”. Po në italishte rifugio ka kuptimet “strehë, strehim, bunker”, pra është tjetër gjë nga rifuxho e shqipes. Ky riinterpretim i pavetëdijshëm, i paqëllimshëm i fjalëve quhet etimologji e rreme.

Po etimologjia popullore për të cilën po flasim, është tjetër gjë. Ajo është përpjekje e





qëllimshme për të shpjeguar fjalët. Praktikuesit e saj janë inxhinierë, ekonomistë, mekanikë etj., përgjithësisht njerëz pa formim linguistik, të cilët i vënë vetes si qëllim të shpjegojnë prejardhjen e fjalëve të shqipes ose të ndonjë gjuhe të huaj. Këta flasin për teknologji e metoda bashkëkohore që përdorin në analizën e gjuhës, kanë shpikur edhe terma, si “operator i lirë” i P. Zhejit ose “embriomorfemë” (morfemë embrionale) e Dalipajt, por të gjitha janë pseudoshkencë. Operatorët e lirë dhe embriomorfemat nuk janë morfema, po tinguj, grupe tingujsh ose pjesë të fjalës të prera sipas dëshirës. P.sh., Zheji fjalën latine *grembus* e nxjerr nga bashkimi i “operatorëve” shqip *gr + em + b + us* “gur jam bë ash(t)”. Kështu edhe Dalipaj, nga i cili po marrim vetëm dy shembuj: Dardani dhe gegërisht. Fjalën Dardani ky nuk e lidh me dardhë si Çabej, po e zbërthen si (n)dar-dy-ani (e ndarë në dy anë, në dy pjesë) dhe këtë sipas tij e tregon folja *nda = n-d-a*, ku *n* është parafjala në, *d* është numërori dy dhe *a* folja asht. Fjalën gegërisht e ndan në *g-egër-isht*, ku *g* është *gj*, pra *gj-egër-isht* “ku egër tregon se bëhet fjala për gjuhën e egër ose e thënë ndryshe të parën... dhe pikërisht prej *g-egër-ishtes* kanë marrë jetë shumë gjuhë

të kultivuara”. Të gjitha këto copëza fjalësh në këta dy shembuj quhen prej tij “morfema embrionale”, po vetëm egër dhe isht janë morfema, veç jo të fjalës gegërisht. Në librat dhe në fjalorët e botuar prej këtyre “etimologëve” gjen marrëzira pa fund, po këtu, për arsye vendi, po përmendim vetëm disa. Kështu, në një libër që mban titullin “Tanagra”, fjalën Tanagra (emri i një qyteze në Beoti të Greqisë), autori e nxjerr nga shqipja “tana gra”, dmth. të tëra gra (!). Po këtu, emri i masivit malor Durmitor në Mal të zi shpjegohet si “dur mi dor”, duke e argumentuar se në kuvende betoheshin duke “vënë durt mi dorë”, dhe emri grek *Omfalos* shpjegohet si i ardhur nga fjalia shqipe “O m’fal”(!). Në një libër tjetër faraon zbërthehet në “fara jon”. Te Dalipaj kemi Dardanele “(n)dar d(y) (a)n e le”, dmth. që të le (të lejon) të kalosh; ibrik (fjalë turke) “(n)i bri ka”, një bri ka; manastir “më-an-shtir”, i lënë mënjanë; kolose “ku-o los-e”, ku është lozur etj. Të tilla budallallëqe vetëm një mendje e çakërditur mund t’i pjellë! England Ready to Launch Vaccination Program Amid New VariantKeep Watching Fatkeqësisht, edhe në doktorata të mbrojtura në universitetet tona, madje dhe në shkrime të botuara në

revista të huaja, gjejmë me shumicë etimologji të gabuara. P.sh., në një shkrim të dr. Marina Kaishit, të botuar në revistën me ISSN “Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences” IIPCCL Publishing, Graz-Austria, Vol. 4, No. 1, March, 2018, autorja i nxjerr me origjinë greke fjalë të shqipes, si: *doke* e *gorromiset* (formime brenda shqipes), *qersë* (fjalë e trashëguar), *kumbari* e *lavosje*, të formuara me prapashtesa shqipe, e para nga *kumbar* (latino-romane) dhe e *dyta* nga greqishtja *lavos*; ose fjalë që shqipja i ka huazuar prej gjuhësh të tjera, si *kaish* (nga turqishtja), *davet* (nga arabishtja në turq.), *hatër* (nga arab. në turq.), *porot* e *porotnik* (nga serbishtja), *pretor* (nga latinishtja), *pusullë* (nga serbishtja), *sepet* (nga persishtja në turq.), *tagar* e *takat* (nga turq.). Broçkullat etimologjike, që nuk kanë asgjë të përbashkët me shkencën e etimologjisë dhe që autorët e tyre rreken t’i shesin si shkencë moderne, kanë pushtuar mendjet e patriotëve folklorikë anembanë hapësirave shqipfolëse. Ato jo vetëm që janë tërësisht pseudoshkencore, po janë edhe shumë të dëmshme në rrafshin kombëtar. Për të kuptuar falsitetin e tyre, mjafton të kujtojmë se që në klasë të pestë nxënësit

mësojnë të bëjnë analiza fjalëformuese të fjalëve të prejardhura të shqipes. P.sh., gegërisht e nxjerrin nga tema Gegëri me prapashtesën -sht, ashtu si toskërisht, çamërisht, labërisht nga temat Toskëri, Çamëri dhe Labëri me të njëjtën prapashtesë dhe, më tej, të gjitha këto fjalë i zbërthejnë si formime me prapashtesën -(ë)ri nga temat gegë, toskë, çam, lab. Këtu analiza fjalëformuese ndalet, ngaqë këto fjalë-rrënjë nga pikëpamja e sotme janë të pazbërthyeshme. Prej këtu fillon analiza etimologjike, e cila ka si objekt pikërisht morfemat e pazbërthyeshme: rrënjët e fjalëve dhe ndajshitesat. Pra, etimologu merret me fjalët gegë, toskë, lab e çam dhe me prapashtesat -(ë)ri e -sht. Kurse “etimologët” e vetëshpallur e shpërfillin këtë, madje e quajnë të vjetruar, antishkencore. Pikërisht, në moskuptimin e objektit të etimologjisë e gjen shpjegimin edhe akuza që i bëhet prof. Çabejt se 93–97% të fjalëve të shqipes i ka nxjerrë të huaja. Ai është marrë me fjalët rrënjë dhe dihet se numri i këtyre nuk e arrin shifrën dhjetë mijë as në gjuhët me fjalor shumë të pasur. Pra, akuza e patriotëve folklorikë për përqindjet bazohet në një llogaritje të gabuar. Etimologjitë që mbështeten vetëm në ngjashmërinë tingullore të fjalëve, nuk janë

shkencore dhe autorët e tyre nuk janë etimologë. Sepse mund të gjenden fjalë të shqipes të ngjashme fonetike me fjalë të japonishtes apo të gjuhëve të aborigjenëve të Australisë a të Brazilit, po këto janë përputhje të rastit. Përndryshe, do t’u mohonim shqiptarëve autoktoninë dhe do t’i nxirrnim të ardhur nga Japonia, nga Kina apo nga xhunglat e Amazonës, çka u shkon pas midësë atyre që na mohojnë prejardhjen ilire dhe autoktoninë. Etimologu i vërtetë e sheh fjalën që merr në shqyrtim nga tri anë: nga ana fonetike, nga ana morfologjike dhe nga kuptimi. Ai nuk kënaqet me konstatimin se një fjalë rrënjë e shqipes ngjan nga ana fonetike me një fjalë tjetër brenda gjuhës ose me një fjalë të një gjuhe me të cilën shqipja ka pasur kontakte historike, po sheh edhe a janë të lidhura këto morfologjikisht dhe kuptimisht. Që të bëhesh etimolog, duhet njohja e gjuhëve klasike, greqishtes së vjetër, latinishtes e sanskritishtes, sllavishtes së vjetër, gjermanikishtes, keltishtes, armenishtes, gjuhëve balte etj. Po kjo premisë është e pamjaftueshme. Duhet edhe një formim linguistik solid, që nënkupton njohjen e fonetikës historike dhe të gramatikës historike të gjuhës tënde dhe



të gjuhëve të cilave u referohesh. Pikërisht, një formim të tillë e pati prof. Çabej, që e mori në universitetet e Gracit e të Vjenës me profesorë gjuhëtarë me emër si Norbert Jokli, Paul Kreçmeri etj.

Prof. Çabej nuk e gjeti të palëvruar fushën e etimologjisë së shqipes. Me të ishin marrë të huajt, duke nisur që nga mesi i shek. XIX e deri në kohën e tij. Është një listë e gjatë gjuhëtarësh pararendës, ndër të cilët shquhen për ndihmesat e tyre Franc Mikloshiçi, Gustav Majeri, Holger Pedersen, Norbert Jokli, Karlo Taliavini etj. Nga shqiptarët, me etimologji janë marrë Dh. Kamarda, Marko la Piana, Petro Furiqi e A. Xhuvani, të cilët sollën ndihmesa të pjesshme në këtë fushë, edhe sepse nuk e patën etimologjinë objekt të vetëm të punës së tyre.

Ndryshe nga paraardhësit, prof. Çabej e bëri etimologjinë objekt kryesor të punës së vet, duke e sjellë etimologjinë e shqipes, ashtu si dhe historinë e saj, në truallin e saj amtar. Rezultatet e punës së tij ai i botoi në revistat tona gjuhësore nga viti 1960 deri më 1980, kur mbylli sytë. Ai i pasuroi e i thelloi arritjet e veta

në këtë fushë në veprën 7-vëllimëshe "Studime etimologjike në fushë të shqipes", të botuar nga Akademia jonë e Shkencave. Duke vlerësuar punën e bërë nga të huajt, prof. Çabej vuri në dukje edhe mangësitë e tyre: njohjen e kufizuar të leksikut të shqipes dhe të botës shqiptare; mbiçmimin e rolit dhënës të gjuhëve të huaja, sidomos të latinishtes, dhe të rolit marrës të shqipes; të meta të metodave të përdorura dhe të parimeve të ndjekura prej tyre etj. Kështu, në kërkimet etimologjike të të huajve përgjithësisht kemi vetëm krahasimin e fjalëve të shqipes me fjalë të huaja, po mungon krahasimi i fjalëve brenda shqipes; mungojnë të dhënat nga dialektet dhe onomastika, sepse dialektologjia është një shkencë gjuhësore e lëvruar tek ne vetëm nga vitet '50 të shekullit të kaluar e këndeje dhe onomastika e shqipes nuk ishte mbledhur.

Kërkimet e prof. Çabej mbështeten në parime të rrepta shkencore dhe në një metodë të re, në metodën e fjalëve dhe të sendeve, të përvijuar nga Hugo Shuhardi, e cila e lidh jetën e fjalës me objektin që emërton, duke e ndjekur shtrirjen e saj në hapësirë dhe në kohë. Përveç

kësaj, rezultatet e arritura prej tij mbështeten në një material shumë më të pasur leksikor, në të dhënat e studimeve dialektore dhe në onomastikën e shqipes; në të dhëna historike, gjeografike, të kulturës materiale e shpirtërore të popullit tonë.

Si rrjedhim, ai arriti të bëjë etimologjinë e shumë fjalëve të pashpjeguara më parë ose të shpjeguara në mënyrë të gabuar dhe shumë fjalë që mbaheshin si huazime, ia ktheu shqipes, duke e rritur fondin autokton të saj. Për këtë mjafton të krahasojmë fjalorin etimologjik të G. Majerit me përfundimet e pjesshme të prof. Çabejt. Majeri, nga 5140 fjalë që ka fjalori i tij, 3980 i nxjerr të huazuara, 400-410 të trashëguara nga gjuha mëmë indoeuropiane dhe 730 të pazbërthyeshme. Pra, Majeri vetëm 8 për qind të fjalorit e nxjerr si autokton. Kurse prof. Çabej, në përpjekjen për të dhënë një statistikë të raportit fjalë shqipe – fjalë e huaj, provoi se leksiku vendës mbizotëron në atë pjesë të tij që ka lidhje me natyrën dhe me një ekonomi e kulturë baritore e agrare, ndërsa leksiku i huazuar vërehet në fushat e kulturës materiale e morale dhe të leksikut abstrakt. Dhe nga shqyrtimi i 1424 fjalëve të

këtyre fushave ai arrin në përfundimin se 667 fjalë vendi qëndrojnë përballë 757 huazimeve. Pra, rreth 48% të fjalëve rrënjë në këto fusha janë të shqipes. Këtë statistikë, që e quan të paplotë dhe jopërfundimtare, profesori nuk arriti ta plotësonte edhe për fushat e tjera të fjalorit të shqipes. Por edhe kaq mjafton për të treguar se ai provoi që peshat e elementit shqip në leksikon e përgjithshëm të saj është e madhe. Siç shihet, edhe në këtë pikë duket se sa pa baza janë akuzat e këtyre "etimologëve".

Me punën e tij në këtë fushë, prof. Çabej hodhi poshtë mendimin që mbivlerëson peshën e elementit të huaj në fjalorin e shqipes. Veç kësaj, ai vuri në dukje edhe rolin dhënës të shqipes ndaj gjuhëve të tjera, gjë që nuk e gjejmë tek studiuesit e mëparshëm. Sigurisht, këto gjëra nuk mund t'i dinë "etimologët" tanë, të cilët nuk janë në gjendje ta lexojnë dhe ta kuptojnë veprën e tij.

Rrufetë e tyre mbi emrin dhe veprën e prof. Çabejt të kujtojnë atë fjalën e urtë popullore që thotë: "Pemën me kokrra e gjuajnë me gurë." Kurse komentet në rrjetet sociale, ku përfshihen kryesisht të rinj pa nivel

kulturor, që shkojnë pas berihasë dhe që ekzaltohen me etimologjizimet e fandaksura, janë tregues i injorancës në rritje në radhët e brezit të ri.


Për ta tejkaluar këtë gjendje, shkollës, në radhë të parë, i takon të bëjë më shumë në lëndën e gjuhës shqipe për ta formuar më mirë gjuhësisht brezin e ri dhe për ta njohur me arritjet e shkencës sonë gjuhësore. Po edhe media, sidomos ajo televizive, ka rolin e saj edukues. Gazetarët, para se të ftojnë për të trajtuar tema gjuhe, duhet të ndriçohen vetë për temën dhe të kërkojnë mendimin e specialistëve, me qëllim që t'u mbyllin dyert sharlatanëve që hiqen si gjuhëtarë e si historianë.

Mendojmë se është koha që Akademia jonë e Shkencave të ribotojë vëllimin e parë të "Studimeve etimologjike..." (vetëm pjesën shqip), në të cilin profesori parashtron objektin e etimologjisë, parimet e saj e metodën e ndjekur dhe jep përmbledhtas rezultatet e arritura prej tij. Do t'u vinte në ndihmë njerëzve normalë për të kuptuar kontributet e prof. Çabejt dhe për të shpërndarë mjegullën e krijuar nga kritikët e tij, "etimologë" pa kurrfarë përgatitjeje gjuhësore e komentues pa tru.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Ballkani kualifikohet në fazën e grupeve, Partizani dhe Struga eliminohen nga Liga e Konferencës

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 GUSHT - FC Ballkani ia ka zditur fytyrën futbollit të Kosovës për herë të dytë radhazi, pasi arriti që të enjten mbrëma të siguron kualifikimin në fazën e grupeve në Ligën e Konferencës, duke shkruar kështu historinë e klubeve kosovare dhe në përgjithësi atyre shqiptare sa i përket pjesëmarrjes në garat evropiane. Kampionia e Kosovë s që drejtohet nga trajneri Ilir Daja e ka prerë biletën për në fazën e grupeve përkundër humbjes në ndeshjen e kthimit të fazës së "play-off"-it nga skuadra e njohur bjelloruese, BATE Borisov (0-1). Ballkani arriti ta menaxhojë epërsinë bindëse nga ndeshja e parë në "Fadil Vokrri" 4-1, duke u kualifikuar më meritë tutje në garat evropiane. Ndeshja e zhvilluar në Hungari u mbyll 1-0 për bjellorusët, me golin e vetëm të

Artem Kontsevoy, në minutën e 30-të. Gjithsesi, kualifikimi i FC Ballkanit në fazën e grupeve për herë të dytë dëshmon rritjen e madhe që futbollit i Kosovës ka bërë viteve të fundit dhe njëherësh është frymëzim për zhvillim të mëtutjeshëm të Superligës dhe klubeve tona në përgjithësi. Pas këtij suksesi ka reaguar skuadra nga Suhareka e cila ndihet krenare për suksesin e arritur dhe rreshtimin e flamurit shtetëror krahas vendeve më të forta. "Për të dytin vit radhazi, e bëmë detyrën, për çka kemi punuar pa ndalur në asnjë moment. Si përfaqësuesit kryesorë të Republikës, luftuam pa reshtur për shtetin dhe emblemën tonë reprezentative. Kemi dhënë gjithçka nga vetja, që flamuri ynë shtetëror të rreshtohet aty ku e ka vendin, në mesin e më të mirëve në Ligë n e Konferencë s. Tani jemi më të lehtësuar, por aspak të vetë mjaftuar, pasi na pret përpara një rrugë edhe më e vështirë.



Faleminderit të gjithëve për mbështetjen, është koha jonë, koha e Ballkanit", thuhet në reagimin e Ballkanit. Partizani është eliminuar në "play-off" të Ligës së Konferencës nga Astana. Kampionët e Shqipërisë e

humben ndeshjen e parë 1-0, kurse në ndeshjen kthyesë barazuan 1-1 në "Elbasan Arena". Ndërsa skuadra tjetër shqiptare, Struga nuk ka arritur që të shkruajë historinë për tu kualifikuar në grupet e Ligës së Konferencës, pasi

edhe në ndeshjen e kthimit të fazës "play-off" u mund nga Breidablik i Islandës me rezultat 1-0 dhe me shifra të përgjithshme 2-0 eliminohet nga kjo garë, duke mbyllur kështu aventurën evropiane për këtë verë.

## Gliha zbulon listën, Korenica 'hasreti' i Superligës



PRISHTINË, 31 GUSHT - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Primozh Gliha, e ka publikuar listën e futbollistëve për dy ndeshjet e muajit shtator në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2024" kundër Zvicrës dhe Rumanisë. Në listë janë përfshirë 27 futbollistë. Nuk mungojnë edhe emra të rinj. I ftuar i vetëm nga Superliga e Kosovës është Meriton Korenica i skuadrës së

Ballkanit, ndërsa Gliha pas një kohe të gjatë në përfaqësuese e ka rikthyer anësorin Bernard Berisha. Pjesë e "dardanëve" për ndeshjet e shtatorit janë edhe Berisha, Zeneli, Bytyqi dhe Hadergjonaj. Grumbullimi i "dardanëve" nis më 4 shtator, derisa më 9 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" zhvillohet ndeshja Kosovë - Zvicër. Lista e futbollistëve: Arjanet

Muriq, Samir Ujkani, Visar Bekaj, Mërgim Vojvoda, Leart Paqarada, Amir Rrahmani, Fidan Aliti, Ibrahim Dreshveq, Kreshnik Hajrizi, Ismajl Beka, Betim Fazliji, Florent Hadergjonaj, Valon Berisha, Florian Loshaj, Florent Muslija, Milot Rashica, Edon Zhegrova, Ermal Krasniqi, Vedat Muriqi, Zymer Bytyqi, Bernard Berisha, Arbër Zeneli, Altin Zeqiri, Meriton Korenica, Valon Zumberi.

## FVK-ja rrit shpërblimet për kampionin dhe nënkampionin

PRISHTINË, 31 GUSHT - Bordi i Federatës i Volejbollit të Kosovës në mbledhjen e radhës ka vendosur për rritjen e shumës së shpërblimit për ekipet kampione në Superligën A të të dyja konkurrencave. Rritja është bërë për 100 % në raport me shumën e deritashme. Kampioni i edicionit 2023/24 do të marrë 5 mijë euro, kurse nënkampioni 2 mijë euro.

Deri tash kampioni ka fituar 2 mijë e 500 euro, kurse nënkampioni 1 mijë euro. Në këtë formë FVK-ja synon ta fillojë një trend të vazhdueshëm të rritjes nga viti në vit, për t'i motivuar ekipet e volejbollit dhe në shërbim të komunitetit të volejbollit. Po ashtu, për herë të parë në listë të shpërblimeve do të futen edhe kampionët e

grupmoshave. Sipas vendimit të bordit të FVK-së, kampionët e edicionit 2023/2024 U18 (m & f) do të shpërblehen nga FVK-ja 900 euro, kurse nënkampionët do të marrin 400 euro. Superliga A (m & f) do t'i fillojë garat e edicionit 2023/24 më 30 shtator-1 tetor 2023, kurse Superliga B dhe Liga e Parë në të dyja konkurrencat nis garat më 7/8 tetor 2023.



## Muja nga sot është edhe nga Lushnja

LUSHNJË, 31 GUSHT - Kryetarja e Bashkisë së Lushnjës, Eriselda Sefa, e ka pritur në takim futbollistin më të ri të kombëtares shqiptare,

Arbnor Mujën. Ajo, po ashtu, njoftoi që Muja është tashmë edhe Qytetar Nderi i këtij qyteti. "Në fotografi me talentin kuqezi Arbnor Muja, i cili do të na

përfaqësoje në Uefa Champions League në sezonin e ri me skuadrën e tij belge Antwerp! Kënaqësi që Arbnorin, gjithashtu, e kemi qytetarin më të ri të

Lushnjës", ka shkruar Sefa në "Facebook". Muja është shqiptar i Kosovës i cili së fundmi zgjodhi të luajë për Shqipërinë.





## Pioli para ndeshjes me Romën: Ardhja e Lukakut nuk na tremb

MILANO, 31 GUSHT - AC Milan të premten ka një përballje mjaft në transfertë. Do të ndeshet me Romën e Jose Mourinhos. "Verdhekuqtë" kanë arritur të bëjnë një goditje të madhe në merkato, duke firmosur me

Lukakun, mirëpo për trajnerin e kuqezinjve, Stefano Pioli, ky është një stimul. "A e komplikon Lukaku ndeshjen ndaj Romës në transfertë? Jo shumë për sa i përket ambientit, sepse janë shitur

biletat në Romë gjithmonë. Por është bukur të luash në stadione plot me këtë atmosferë. Ne punojmë për këto ndeshje. Ardhja e Lukakut nuk na tremb, por na stimulon. Roma pa Dybalan dhe

Lukakun? Me ose pa Dibaln dhe Lukakun, Roma është e fortë, e organizuar, shumë fizike, e rrezikshme, pëson pak, e fortë në grupe. Ne duhet të jemi të përgatitur", ka thënë Pioli.



## Kroos: Në futbollin e Arabisë Saudite gjithçka rrotullohet rreth parave

MADRID, 31 GUSHT - Mesfushori i Real Madridit, Toni Kroos, për herë të dytë brenda një jave i ka kritikuar lojtarët që kalojnë në Arabinë Saudite, duke i akuzuar ata si mercenarë. Ndjenjat e tij u bënë shumë të qarta javën e kaluar kur u publikua lajmi se Gabri Veiga do të largohet nga Celta Vigo për Al Nassrin pavarësisht se kishte shansin të shkonte në një numër klubesh të tjera kryesore në Evropë, duke e quajtur vendimin e 21-vjeçarit "të turpshëm". Kroos ka hedhur poshtë idenë se futbollin e Arabisë Saudite është diçka tjetër veçse një dëshirë për t'u pasuruar. "Është thënë se futbollin atje është ambicioz, por gjithçka rrotullohet rreth parave. Në fund, është një vendim për para dhe kundër futbollit", ka thënë Kroos për "Einfach Mal Luppen". Kroos ishte më pak i ashpër me veteranët që shkuan në fundin



e karrierës: "Atëherë fillon të jetë e vështirë për futbollin që të gjithë e njohim dhe e duam. Secili duhet ta marrë këtë vendim për veten e tij, si Cristiano Ronaldo, i cili vendosi ta bëjë atë në fund të karrierës

së tij. Por bëhet shumë e vështirë kur lojtarët, të cilët janë në mes të karrierës së tyre dhe kanë cilësinë për të luajtur për klubet më të mira në Evropë, vendosin t'i bëjnë këto ndryshime", ka shtuar Kroos.

## Legjenda e boksit rikthehet në ring në moshën 45-vjeçare, synon Lojërat Olimpikë 'Paris 2024'

KIBAWE, 31 GUSHT - Legjenda e boksit Manny Pacquiao synon të rikthehet në ring në moshën 45 vjeçe. Senator në Filipine, ish-kampioni i shumëfishtë i botës synon ta përfaqësojë vendin në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Lajmin e konfirmoi presidenti i Komitetit Olimpik Filipinas, Abraham Tolentino: "Stafi i Pacquiao më ka kontaktuar dhe më ka shpalosur idenë e idhullit tonë të boksit për të marrë pjesë në Olimpiadën e ardhshme. Ai nuk mund ta sigurojë pjesëmarrjen në Lojërat Aziatike që janë në muajin e ardhshëm në Kinë, pasi është mbi 40 vjeç. Gjithsesi, Pacquiao mund ta realizojë këtë gjë në turnetë e ardhshëm", ka thënë presidenti i Komitetit Olimpik Filipinas. Sipas rregullores, Pacquiao mund të marrë pjesë në një nga dy turnetë kualifikues të Botërorit 2024. Në Filipine po lëvizin çdo gur pranë IOC dhe Federatës



Ndërkombëtare të Boksit për t'i garantuar Pacquiao dhe projektit të tij të gjithë mbështetjen e

mundshme. Boksieri peshon 66 kg dhe mund të zgjedhë mes kategorive 63.5 kg dhe 71 kg.

### SHKURT

#### Kryeziu vazhdon kontratën me Prishtinën

FC Prishtina ka njoftuar se sulmuesi Leotrim Kryeziu e ka vazhduar kontratën deri në vitin 2025. "FC Prishtina dhe Leo e kanë gjetur gjuhën e përbashkët për vazhdimin e bashkëpunimit. Kryeziu pjesë e Prishtinës është që nga viti 2021, teksa me skuadrën tonë i ka fituar të gjithë titujt e mundshëm në futbollin tonë", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas.

#### Lukaku paraqitet te Roma: Mezi pres të filloj

Tashmë është zyrtare, Romelu Lukaku është lojtar i Romës. Sulmuesi belg ka firmosur kontratën me ekipin romak. Lukaku do të jetë në huazim nga Chelsea te Roma për një sezon, pra verën e ardhshme ai do të rikthehet te Chelsea. "Tifozët e Romës ishin të magjshëm për mua. Mezi pres të filloj. Drejtuesit këtu kanë ambicie të mëdha", ishin fjalët e para të Lukakut si lojtar i Romës. Ish-sulmuesi i Evertonit, Manchester Unitedit dhe Interit pritët të debutojë ndaj Milanit sonte (e premte).

#### Ofertë befasuese nga Skocia për Hazardin

Një ofertë befasuese nga futbollin skocez ka marrë ish-ylli i Chelseat, Eden Hazard, i cili është larguar nga Real Madridi dhe thuhet po e shqyrton mundësinë e pensionimit. Gazeta "AS" në Spanjë raporton se sulmuesi belg karrierën mund ta vazhdojë në Premiership skocez. Identiteti i klubit nuk është i qartë, por raporti sugjeron se njëra nga dy klubet e mëdha, Rangers ose Celtic, mund të kenë qenë të interesuara. Hazardi nga Lille u transferua në Chelsea ku la gjurmë të mëdha, por më pas u transferua në Real Madrid dhe karriera e tij gjithnjë e më shumë pësoi rënie, duke mos qenë në gjendje të lërë gjurmë në klubin madrilen.

#### Tottenhami ofron 150 milionë euro për Rodrygon, Reali e refuzon

Pas shitjes së Harry Kanes, skuadra e Tottenhamit ka synuar të sjellë në Premierë Ligë sulmuesin Rodrygo, që luan me ekipin e Real Madridit. Për t'i siguruar shërbimet e 22-vjeçarit, "Spurs" kishte ofruar 150 milionë euro, një shumë që kishte tunduar presidentin Florentino Perez. Por ai që kishte vënë veton, duke mbyllur që në start çdo mundësi të largimit të brazilianit ishte trajneri Carlo Ancelotti. Sipas "Mundo Deportivo", trajneri italian kishte refuzuar largimin e Rodrigos, duke e konsideruar të pashitshëm. Kështu, nga Reali erdhi një përgjigje e prerë: "JO" për sulmuesin e talentuar brazilian, që do të vijojë të jetë pjesë e "Los Blancos".

## Bonucci transferohet në Bundesliga

Mbrojtësi legjendar Leonardo Bonucci do ta vazhdojë karrierën

në Gjermani. Sipas raportimeve, qendërmbrojtësi ka arritur

marrëveshje me ekipin gjerman Union Berlin. Kontrata do të jetë

deri në qershor 2024, kurse po diskutohet edhe mundësia për

zgjatje të kontratës edhe për një tjetër sezon.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 723/1  
Dt: 31.08.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 07/2017, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### RI-SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të punës në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2023/2024


Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës/e për TIK (20 orë mësimore)	Zëvendësim

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore tënxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

#### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvijës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
  - Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacioni dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.
  - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvijën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
  - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjeipuneshpejite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Cen Muqaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. "NexhmedinNixha".

- SALIH AHMETI, Shpall te pavleshme deftesat 10,11,12 DHE DIPLOMEN E SHMLT "ARKITEKT SINANI"

- SARA KABASHI, Shpall te pavleshme deftesen e shkolles fillore ;NONDA BULKA"

- Yll Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "NexhmedinNixha".

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "NexhmedinNixha".

- Luisna Karaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.t. "Kadri Kusari".

- OsmonSeferi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "FehmiLladrovci" Drenas.

- Luisna Karaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m.t. "Kadri Kusari".

- Tehnoburimi D.D SH.A shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810548307.

- Ibrahim Bajrami shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani".

- Lejla Peci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- Kumrije Rexhepi B.I shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal 812051100.

- D.P.T. Instalimi -ASHB shpall të humbur arken fiskale me nr. Serik: DG-06603079.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



